



**Syri i Vizionit**

**NGO "Syri i Vizionit"**

Rr. Isa Demaj nr.14, 30000, Pejë, Kosovë

+383 (0) 39 423 240, +383 (0) 44 111 408

info@syriivizionit.org, www.syriivizionit.org

**mendo globalisht, vepra lokalisht**

## **SHPALLJE PËR VEND PUNE**

**Titulli i punës:** Mentor/e

**Vendi i Punës:** Pejë, Mitrovicë, Ferizaj

**Fillimi i punës:** 1 Prill 2024

**Kohëzgjatja:** Kontratë 20 Mujore

Syri i Vizionit ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë. Në përpjekjet e vazhdueshme për praktika demokratike, "Syri i Vizionit" i ka dhënë rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mirë, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Syri i Vizionit kërkon të punësojë tre mentor/e të cilët do të angazhohen në kuadër të projektit **"Fuqizimi i komuniteteve të cenueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës"** i cili do të implementohet në partneritet me Save the Children Kosova dhe është financuar nga Agjensia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Mentorët do të jetë përgjegjës për të punuar ngushtë me menaxhmentin e programit për zhvillimin e aktiviteteve të parapara në kuadër të programit, punë të ngushtë me nxënësit të rinjtë dhe prindërit.

Përpos punës me stafin e programit të SIV, mentorët do të punojë edhe me stafin dhe partnerët e projektit; do të bëjë plane, metodologji materiale të zhvillimit personal dhe orientim në karrierë, raporte etj.

### **FUSHAT KRYESORE TË PËRGJEGJËSISË: Mentor/e:**

- Punon me menaxherin e programit që të sigurojë zbatimin e Standardeve të cilësisë të programit në kuadër të Syri i Vizionit
- Sigurimi i materialeve mësimore dhe organizimi i aktiviteteve të zhvillimit personal dhe orientimit në karrierë me vajza dhe djem të rinj.
- Merr pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e projektit
- Prezanton projektin tek palët e interesit dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet ku shtrihet projekti duke përfshi shkollat dhe institucionet lokale
- Punon ngushtë me akterët dhe ekipet e parandalimit të braktisjes
- Organizon aktivitete dhe trajnime për përfituesit e projektit

- Përpilon raport për aktivitet sipas kërkesës
- Ofron mbështetje në kuadër të fushatave që do të zhvillohen në projekt
- Komunikon dhe bashkëpunon me stafin drejtues dhe të akterëve të projektit në vlerësimin dhe raportimin e nevojave specifike dhe edukative të grupeve të interesit
- Trajton/ofron mbështetje të shkathtësive në bazë të nevojave të identifikuara, në bashkëpunim me stafin dhe drejtuesit e programit
- Merr pjesë aktive dhe angazhohet në sesionet trajnimit mbi qasjen e aftësive për jetë (LS4S) dhe aplikimin e saj në sesione mentorimi me nxënësit në shkollat e mesme profesionale që janë pjesë e projektit.
- Punon drejtpërdrejt me nxënësit në shkollat e mesme profesionale me fokus të komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke zhvilluar sesione mentorimi në grupe të vogla ose në baza individuale.
- Udhëzon, inkurajon nxënësit në zhvillimin e aftësive të nevojshme të përcaktuara në qasjen se aftësive për jetë (LS4S).
- Mentoron dhe monitoron përparimin dhe arritjet e nxënësve, duke dokumentuar zhvillimin e tyre dhe çdo sfidë ose vështirësi që hasin gjatë procesit të mentorimit.
- Aplikon komunikim të hapur dhe efektiv me stafin e projektit, raporton rregullisht për aktivitetet e mentorimit, përparimin dhe sfidat që hasen.
- Bashkëpunon me mentorë të tjerë, stafin e organizatës dhe palë tjera të interesit për të siguruar zbatimin e suksesshëm të qasjes se aftësive për jete (LS4S) dhe arritjen e objektivave të programit.
- Respekton udhëzimet dhe standardet etike të vendosura nga SiV, duke siguruar gjithmonë sigurinë, mirëqenien nxënësve/të rinjve në aktivitete.
- Monitoron dhe dokumenton progresin dhe arritjet e të nxënësve, si dhe sfidat apo vështirësitë me të cilat ata përballen.

### **Raportimi**

- Punon ngushtë me menaxherin e programit dhe stafin e projektit që të sigurojë përgatitjen me kohë të raporteve të brendshme dhe të jashtme e produkteve përkatëse; vërteton saktësinë, kohën dhe përshtatshmërinë e informacionit.
- Përgatit raportet e konsoliduara javore të programit dhe organizon mësim të duhur për të shpërndarë arritjet kryesore në kuadër të projektit.

### **Kualifikimet dhe përvoja:**

- Diplomë universitare në drejtim të shkencave shoqërore apo ndonjë fushë përkatëse /Titulli Master është një përparësi



**Syri i Vizionit**

**NGO "Syri i Vizionit"**

Rr. Isa Demaj nr.14, 30000, Pejë, Kosovë  
+383 (0) 39 423 240, +383 (0) 44 111 408  
info@syriivizionit.org, www.syriivizionit.org

**mendo globalisht, vepra lokalisht**

- Demonstron përvojë të mëparshme në mentorim, zhvillimin e rinisë ose fusha të ngjashme, idealisht duke punuar me grupe të moshës dhe komunitete të ngjashme.
- Gatishmëri për të marrë pjesë në sesione trajnimi intensive mbi qasjen LS4S dhe teknikat e mentorimit
- Shkathtësi të larta ndër-personale dhe komunikuese
- Shkathtësi të larta lehtësuese dhe prezantuese
- Shkathtësi trajnuese, zhvillim kapacitetesh, këshillimi dhe mentorimi
- Shkathtësi të shkëlqyeshme TI [Microsoft Office]
- Përkushtim dhe mirëkuptim për synimet, vlerat dhe parimet e programit në kuadër të Syri i Vizionit, përfshirë edhe qasjet e bazuara në të drejta
- Aftësi në punë ekipore dhe vet-iniciativë
- Njohje e gjuhës angleze në të shkruar dhe folur, gjuha serbe apo boshnjake është një përparësi
- Të mos jetë i dënuar apo nën hetime për vepra penale

#### **Preferohet**

- Përvojë pune në ndonjë organizate lokale joqeveritare apo të ngjashme
- Patentë shoferi, kategoria B

**Politika e mbrojtjes së fëmijëve** (Si kusht për lidhjen e një marrëveshjeje pune, mentori/ja duhet të nënshkruajë Politikën për Mbrojtje të Fëmijëve të Syri i Vizionit dhe të respektojë termat dhe kushtet e saj.

#### **Mënyra e aplikimit**

Aplikacionet në gjuhën shqipe (që përfshijnë një letër motivuese dhe Europass CV) duhet të dorëzohen me së voni **me 12 Mars 2023** në formë elektronike në

[office@syriivizionit.org](mailto:office@syriivizionit.org)

[vlora.latifi@syriivizionit.org](mailto:vlora.latifi@syriivizionit.org)

**Ju lutem secili nga kandidatet që aplikon te vendosni subjekt komunën për te cilën aplikoni.**

Vetëm kandidatët që do të futen në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.